

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik FIER

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË

“INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE
KONDITIONERËSH”

Kodi: IMK-2020

Miratoi:

DREJTOR

.....

Fier, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“INSTALIM DHE MIREMBAJTJE KONDICIONERËSH”

(IMK-2020)

I. Profili profesional i Instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve

a) Karakteristikat e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve:

Instaluesi dhe mirëmbajtësi i kondicionerëve është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në pika servisi riparimesh kondicionerësh apo në grupe pune si instalues dhe mirëmbajtës kondicionerësh.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave instaluesi dhe mirëmbajtësi i kondicionerëve duhet që të zotërojë *njohuri dhe shprehje* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve. Suksesi i instaluesit të kondicionerëve është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës .

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve.

Profesioni i instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kontrollin, diagnostikimin, riparimin apo zëvendësimin e pjesëve të kondicionerëve të dëmtuar si dhe shërbime të ndryshme të elementëve mekanike, elektrike dhe elektronike të kondicionerëve (një dhe tre fazorë). Ai mund të punësohet ose të vetëpunësohet në reparte shërbimesh dhe riparimesh të kondicionerëve apo pajisjeve elektroshtëpiake, si dhe në kompani shitjeje. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një instalues dhe mirëmbajtës kondicionerësh mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse”, me kod 7124.6. referuar Listës Kombëtare të Profesioneve .

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: instalues kondicionerësh split, multisplit, një fazor , tre fazorë, mirëmbajtës etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh”

Në përfundin të kursit për Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për instalime dhe mirëmbajtje kondicionerësh;
- bëjnë organizimin e vogël të punës në repartin për instalime dhe mirëmbajtje kondicionerësh;

- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura të punës;
- mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës;
- përdorin dhe interpretojnë skica dhe skema të thjeshta elektrike, elektronike mekanike të kondicionerëve;
- përdorin drejt veglat e pajisjet e punës gjatë instalimeve dhe mirëmbajtjes së kondicionerëve ;
- montojnë bazamentin e brendshëm dhe të jashtëm të kondicionerëve ;
- mirëmbajnë kondicionerët;
- kryejnë riparime të thjeshta në kondicionerë;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për instalime dhe mirëmbajtje kondicionerësh;
- zbatojnë standardet e profesionit gjatë kryerjes së instalimeve dhe mirëmbajtjes së kondicionerëve;
- përdorin teknologjinë e informacioni për aspekte të profesionit;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës;
- zbatojnë legjislacionin e punës;
- komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh”.

240 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Instalim dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh”.

Nr	Titulli i modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet mësimore
1	Hyrje në profesionin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve.	IMK-01-2020	30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve. 2. Kursanti përshkruan veglat, pajisjet dhe materialet në instalimet e kondicionerëve. 3. Kursanti përshkruan dhe interpreton parimet e elektricitetit dhe elektronikës në kondicionerë. 4. Kursanti përshkruan parimet e mekanikës në kondicionerë. 5. Kursanti përshkruan parimet bazë të hidraulikës dhe termoteknikës në kondicionerë. 6. Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit në punë, sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

2	Ventilimi dhe ajri i kondicionuar.	IMK-02-2020	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan sistemin e ventilimit, llojet dhe pjesët përbërëse të tyre në kondicionerë. 2. Kursanti përshkruan parimet e ajrit të kondicionuar. 3. Kursanti përshkruan sistemet për ngrohje - ftohje në kondicionerë.
3	Zgjedhja e modelit dhe fuqisë së kondicionerit.	IMK-03-2020	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përcakton vendin ku do instalohet kondicioneri. 2. Kursanti zgjedh modelin e kondicionerit. 3. Kursanti zgjedh fuqinë e kondicionerit sipas ambjentit.
4	Montimi i kondicionerit një fazorë.	IMK-04-2020	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti monton njësinë e brendshme të kondicionerit një fazorë. 2. Kursanti monton njësinë e jashtme të kondicionerit një fazorë. 3. Kursanti monton tubacionet e linjave të kondicionerit një fazorë. 4. Kursanti kryen lidhjen elektrike të kondicionerëve një fazorë. 5. Kursanti kryen lidhjen e linjave ftohëse dhe tubit të kondensatës. 6. Kursanti kryen operacionet përfundimtare të instalimit dhe kontrollon rrjedhjet.
5.	Montimi i kondicionerit tre fazorë.	IMK-05-2020	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti monton njësinë e brendshme të kondicionerit tre fazorë . 2. Kursanti monton njësinë e jashtme të kondicionerit tre fazorë. 3. Kursanti monton tubacionet e linjave të kondicionerit tre fazorë. 4. Kursanti kryen lidhjen elektrike të kondicionerëve tre fazorë. 5. Kursanti kryen lidhjen e linjave ftohëse dhe tubit të kondensimit të ujit. 6. Kursanti kryen operacionet përfundimtare të instalimit dhe kontrollon rrjedhjet e kondicionerëve tre fazorë.

6.	Montimi i A/C multisplit, portabël, kolonë, ekologjike dhe ekonomike.	IMK-06-2020	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përdor veglat, paisjet dhe materialet për montimin e pjesës së jashtme, të brendshme të kondesimit . 2. Kursanti monton kondicionerë A/C multi/split 3. Kursanti monton kondicionerë A/C portabël. 4. Kursanti monton kondicionerë kolonë. 5. Kursanti monton kondicionerë ekologjikë dhe ekonomik.
7.	Montimi i A/C tavanorë një dhe tre fazorë.	IMK-07-2020	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përdor veglat, paisjet dhe materialet për instalimin e pjesës së jashtme, të brendshme të A/C tavanorë (1-3 fazorë). 2. Kursanti monton A/C tavanorë (1-3 fazorë).
8.	Mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta të kondicionerëve.	IMK-08-2020	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti mirëmban kondicionerët. 2. Kursanti çmonton kondicionerët. 3. Kursanti riparon defekte të thjeshta të rrjedhjeve të fluidit.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet mësimore (RM-të) që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Instalime dhe Mirëmbajtje Kondicionerësh

1. Moduli “Hyrje në profesionin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E INSTALUESIT DHE MIRËMBAJTËSIT TË KONDICIONERËVE	IMK-01-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë, funksionet, detyrat, parimet dhe kërkesat kryesore të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve, me nocionet dhe ligjet bazë të elektricitetit, veglat , paisjet dhe materialet e punës për instalim, mirëmbajtje dhe riparim, me veçoritë dhe kërkesat e këtyre punimeve, me parimet bazë të	

	termoteknikës, elektricitetit, elektronikës, si dhe me rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm , të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht, si dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin, rëndësinë shërbimeve të instalimit dhe mirëmbajtjes së kondicionerëve; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve ; - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve; - të përshkruajë veglat kryesore që përdoren në instalimet dhe mirëmbajtjen e kondicionerëve dhe fushën e përdorimit të tyre; - të përshkruajë llojet, përdorimin dhe vetitë e materialeve që përdoren në instalimet dhe mirëmbajtjen e kondicionerëve; - të përshkruajë llojet dhe përdorimin e kondicionerëve; - të përshkruajë kriteret e përzgjedhjes së kondicionerëve; - të përshkruajë kërkesat profesionale për instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve; - të tregojë mundësitë e punësimit të instaluesit, riparuesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve; - të përshkruajë mundësitë e karrierës profesionale të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve; - të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve; - të përshkruajë kriteret e dokumentacionit dhe legjislacionit në punë. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim.	
	RM 2 Kursanti përshkruan veglat, paisjet dhe materialet në instalimet e kondicionerëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

- të përshkruajë veglat e punës së instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të përshkruajë pajisjet e matjes dhe kontrollit të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të përshkruajë materialet e punës së instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të përshkruajë elementët e punës së instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të shpjegojë llojet dhe vetitë e materialeve termoizoluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3

Kursanti përshkruan dhe interpreton parimet e elektricitetit dhe elektronikës në kondicionerë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë parimet bazë të elektricitetit;
- të përshkruajë terminologjinë bazë të profesionit;
- të përshkruajë skemat elektrike të kondicionerit;
- të interpretojë skemat elektrike të kondicionerit;
- të interpretojë simbolet kryesore që përdoren në skicat dhe skemat elektrike të kondicionerëve;
- të përshkruajë parimet bazë të elektroteknikës;
- të përshkruajë skemat elektronike të kondicionerit;
- të interpretojë skemat elektronike të kondicionerit;
- të përshkruajë efektet kryesore të rrymës elektrike dhe zbatimet e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4

Kursanti përshkruan parimet të mekanikës në kondicionerë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e materialeve që përdoren;
- të përshkruajë bashkimin e detaleve dhe llojet e tyre;
- të përshkruajë llojet e saldimeve, saldimi me gaz;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5

Kursanti përshkruan parimet bazë të hidraulikës dhe termoteknikës në kondicionerë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë parimet bazë të hidraulikës;
- të interpretojë ligjet e termodinamikës;

- të përshkruajë llojet e trasmetimit të nxehtësisë;
- të përshkruajë kërkesat e komfortit termik, ngarkesa termike për ngrohje;
- të përshkruajë faktorët kryesorë ndikues (temperatura, lagështia dhe lëvizja e ajrit).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyete - përgjigje me shkrim.

RM 6 Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit në punë, sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë parimet bazë të etikës profesionale në punë (konfidencialiteti, besueshmëria, etj);
- të përshkruajë rregullat e prezantimit të shërbimit;
- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët, klientët, etj;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- të përcaktojë rreziqet e mundshme, si dhe shkaqet e tyre;
- të përcaktojë masat dhe veprimet për menjanimin e rreziqeve të mundshme;
- të përshkruajë pasojat nga mos zbatimi i rregullores së sigurimit teknik;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga rryma elektrike;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale të instaluesit, riparuesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të përshkruajë rëndësinë e kompletit të veshjes dhe mjeteve mbrojtëse të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve;
- të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyete përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset reale të punës ku kryhen instalime dhe mirëmbajtje të kondicionerëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të nxiten të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete më mjediset e punës të instalimit dhe mirëmbajtjes së kondicionerëve. Atyre duhet t'iu jepen detyra të përshkruajnë

	veçoritë e profesionit të instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve, funksionet, detyrat, veprimtaritë dhe rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit ku mbështetet puna e riparuesit të kondicionerëve. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për e çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës në repart instalimi dhe mirëmbajtje të kondicionerëve . - Kompletet e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme. - Materiale të shkruara si rregullore, manuale, udhëzuesa etj. - Materiale ilustruese, pankarta, transparente, makete, skema të kondicionerëve.

2. Moduli “Ventilimi dhe ajri i kondicionuar”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VENTILIMI DHE AJRI I KONDICIONUAR	IMK-02-2020
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me ajrin e kondicionuar, llojet e sistemeve të ajrit të kondicionuar si dhe me rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë dhe 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti përshkruan sistemin e ventilimit, llojet dhe pjesët përbërëse të tyre në kondicionerë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionin e ventilimit dhe llojet e tij; - të përshkruajë funksionin e ventilimit natyral; - të përshkruajë funksionin e ventilimit të detyruar (shtytës dhe tërheqës); - të përshkruajë llojet e dëmtimeve në ventilim;

- të përshkruajë llojet e ventilatorëve dhe përdorimin e tyre në kondicionerë;
- të interpretojë dokumentacionin teknik të ventilatorëve
- të kondicionerëve ;
- të përshkruajë veçoritë dhe përdorimet e mjeteve,
- veglave dhe pajisjeve të punës;
- të përcaktojë pjesët përbërëse të ventilatorëve;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes së mjedisit gjatë punës me ventilatorët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan parimet e ajrit të kondicionuar.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionin e ajrit të kondicionuar ;
- të përshkruajë konceptet bazë të ajrit të kondicionuar, lagështia relative, temperatura, diagrama, jonizimi ajrit ;
- të përshkruajë përparësit e përdorimit të ajrit të kondicionuar;
- të përshkruajë llojet e sistemeve të ajrit të kondicionuar, një zonal dhe multizonal;
- të tregojë proceset e ajrit të kondicionuar ngrohje - ftohje, lagështimi, delagështimi;
- të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur sisemet e ajrimit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan sistemet për ngrohje - ftohje në kondicionerë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë pjesët përbërëse të njësisë së brendshme, njësinë e jashtme dhe linjat ftohëse;
- të përshkruajë skemat funksionale të kondicionerëve;
- të përshkruajë kartën teknologjike dhe kujdesin për mbushjen dhe zbrazen e fluidit në kondicionerë;
- të përshkruajë llojet e fluideve;
- të përshkruajë agjentët ftohës, llojet dhe kriteret cilësore (normat teknike) bashkëkohorë të tyre;

- të përdorë dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur sistemet ngrohje ftohje;
- të përshkruajë rregullat e kujdesit për veglat dhe pajisjet e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të instalimit dhe mirëmbajtjes të kondicionerëve. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen instalime dhe mirëmbajtje të kondicionerëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të nxiten të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të ventilimit dhe ajrit të kondicionuar. Atyre duhet t’iu jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e llojet e sistemeve të ajrit të kondicionuar, funksionet, veprimtaritë dhe rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit ku mbështetet puna e riparuesit të kondicionerëve.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për e çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në repart instalimi, riparimi dhe mirëmbajtje të kondicionerëve për ventilim dhe ajrim.
 - Repart i riparimeve të kondicionerëve, i pajisur me kompletet veglave pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
 - Materiale të shkruara si rregullore, manuale, udhëzuesat etj.
 - Materiale ilustruese, pankarta, transparente, makete, skema të kondicionerëve.
-

3. Moduli “Zgjedhja e modelit dhe fuqisë së kondicionerit”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZGJEDHJA E MODELIT DHE FUQISË SË KONDICIONERIT	IMK-03-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët me procedurat e zgjedhjes së modelit të kondicionerit si dhe fuqisë së tyre sipas ambjentit ku do instalohen .Ambjenti mund të jetë shtëpi, zyra, biznese etj.	
Kohëzgjatja e modulit	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë të aftë fizikisht, mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve” dhe “Ventilimi dhe ajri i kondicionuar”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përcakton vendin ku do instalohet kondicioneri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të analizojë objektin ku do instalohet kondicioneri; - të përzgjedhë vendin e instalimit të kondicionerit; - të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e vendit ku do instalohet kondicioneri; - të interpretojë dokumentacionin teknik të kondicionerit; - të kryejë matje dhe shënime për vendin e njësisë së brendshme të kondicionerit; - të kryejë matje dhe shënime për vendin e njësisë së jashtme të kondicionerit. - të zbatojë standardet për procedurën e vendit të dy njësive të kondicionerit; - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Listë kontrolli.	
	RM 2 Kursanti zgjedh modelin e kondicionerit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të analizojë objektin dhe të përzgjedhë modelin e kondicionerit; - të përzgjedhë modelin e duhur për ambjentin ku instalohet kondicioneri; - të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e modelit; - të interpretojë dokumentacionin teknik të kondicionerit; - të kryejë matje dhe shënime për montimin e njësisë së brendshme të kondicionerit sipas modelit të zgjedhur;	

- të kryejë matje dhe shënime për montimin e njësisë së jashtme të kondicionerit sipas modelit të zgjedhur;
- të zbatojë standardet për procedurën e instalimit të dy njësive të kondicionerit sipas modelit të zgjedhur;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

RM 3 Kursanti zgjedh fuqinë e kondicionerit sipas ambjentit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë objektin dhe të përzgjedhë fuqinë e kondicionerit ;
- të përzgjedhë fuqinë e duhur për ambjentin ku do të instalohet kondicioneri;
- të komunikojë me klientin mbi zgjedhjen e fuqisë;
- të interpretojë dokumentacionin teknik të kondicionerit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës për zgjedhjen e modelit të kondicionerit.
- Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e bizneseve, reparteve ku bëhen instalime dhe mirëmbajtje të kondicionerëve;
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të nxiten të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të zgjedhjes së modelit dhe fuqisë. Atyre duhet t’iu jepen detyra të përshkruajnë zgjedhjen e fuqisë, modelit të kondicionerëve sipas ambjentit ku do të montohen.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

realizimin e modulit	- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në repart instalimi, riparimi dhe mirëmbajtje të kondicionerëve. - Repart i riparimeve të kondicionerëve, i pajisur me kompletet veglave pajisjeve dhe materialeve të nevojshme. - Materiale të shkruara si rregullore, manuale, udhëzuesat etj. - Materiale ilustruese, pankarta, transparente, makete, skema të kondicionerëve.
-----------------------------	--

4. Moduli “Montimi i kondicionerit një fazorë”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	MONTIMI I KONDICIONERIT NJË FAZORË	IMK-04-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të montuar kondicionerin një fazorë.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm , të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht, si dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e instaluesit dhe mirëmbajtësit të kondicionerëve”, “Ventilimi dhe ajri i kondicionuar” dhe “Zgjedhja e modelit dhe fuqisë së kondicionerit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti monton njësinë e brendshme të kondicionerit një fazorë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse përpara fillimit të punës; - të përgatitë vendin e punës për montimin e njësisë së brendshme; - të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe mjetet e punës për montimin e njësisë së brendshme; - të nxjerrë njësinë e brendshme dhe materialet e duhura për montimin e saj, sipas skicës së instalimit; - të kryejë matje dhe shënime për drejtimit të daljes së linjave; - të përdorë veglat dhe pajisjet për shpimin e vrimave; - të shpojë vrimat me trapan në mur për tubacionet e linjave duke respektuar pjerësinë dhe kuota; - të montojë shpinoren e njësisë së brendshme; - të kryejë fiksimin e njësisë së brendshme; - të zbatojë standardet e instalimeve të njësisë së brendshme; - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit:

-
- Pyetje - përgjigje me gojë.
 - Listë kontrolli.

RM 2 Kursanti monton njësinë e jashtme të kondicionerit një fazorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse përpara fillimit të punës;
- të përgatitë vendin e punës për montimin e njësisë së jashtme;
- të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe mjetet e punës për montimin e njësisë së jashtme;
- të nxjerrë njësinë e jashtme dhe materialet e duhura për montimin e saj, sipas skicës së instalimit;
- të kryejë matje dhe shënime për vendosjen e këmbëzave të njësisë së jashtme;
- të përdorë veglat dhe pajisjet për shpimin e vrimave ;
- të shpojë vrimat shtrënguese;
- të kryejë montimin e këmbëzave të bazamentit dhe shtrëngimi i tyre;
- të kryejë fiksimin e njësisë së jashtme;
- të kryejë zbrasjen e ajrit nga tubacionet me pompë vakumi;
- të zbatojë standardet e instalimeve të njësisë së jashtme;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

RM 3 Kursanti monton tubacionet e linjave të kondicionerit një fazorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse përpara fillimit të punës;
- të përgatitë vendin e punës për montimin e tubacioneve të linjave;
- të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe mjetet e punës për montimin e tubacioneve të linjave;
- të nxjerrë njësinë e jashtme dhe materialet e duhura për montimin e saj, sipas skicës së instalimit;
- të zgjedhë tubacionet sipas parametrave (diametri dhe gjatësia e duhur) sipas modelit të përzgjedhur;
- të kryejë kontrollin e papastërtisë dhe lagështisë së tubacioneve.
- të kujdeset për kthesat e tubove;
- të kryejë izolimi veç e veç të tubacioneve me veshje termoizoluese;
- të hapë kanale të vegjël në mur (kanelinë), nëse është e nevojshme;
- të zbatojë standardet e instalimeve të njësisë së jashtme;

- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

RM 4 Kursanti kryen lidhje elektrike të kondicionerëve një fazorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skemën elektrike të kondicionerit që do të instalohet.
- të përzgjedhë materialet, elementet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për realizimin e skemes elektrike të kondicionerit;
- të kryejë kontrollin e parametrave të fuqisë elektrike të rrjetit që do të furnizojë kondicionerin;
- të përzgjedhë kabllot elektrike për njësinë e brendshme dhe të jashtme si dhe çelës mbrojtës dhe atë diferencial;
- të matë, presë dhe montojë në panel tubat ose kanalinat plastike, sipas skemës elektrike;
- të kryejë lidhjen elektrike të njësisë së brendshme;
- të kryejë lidhjen elektrike të njësisë së jashtme;
- të zbatojë standardet e instalimeve të njësisë së jashtme;
- të bëjë matjet, kontrollet, rregullimet e duhura dhe provën e funksionimit të lidhjes elektrike të kondicionerëve;
- të zbatojë rregullat e kujdesit të veglave dhe pajisjeve të punës;
- të zbatojë standardet dhe kërkesat teknike gjatë realizimit të lidhjeve elektrike në kondicionerët një fazorë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes mjedisit gjatë realizimit të lidhjeve elektrike në kondicionerët një fazorë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen lidhjen e linjave ftohëse dhe tubit të kondesatës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse përpara fillimit të punës;
- të përgatitë vendin e punës për montimin e linjave ftohëse të kondesatës;
- të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe mjetet e punës për montimin e tubacioneve të linjave;
- të kryejë montimin e varjes të njësisë së brendshme në shpinoren e vendosur në mur;
- të kryejë përgatitjen për fllanxhimimin e tubacioneve;
- të kryejë fllanxhimimin e tubacioneve.
- të kryejë kalimin e linjave në virrën e murit;

- të kryejë lidhjen përfundimtare të tubacioneve dhe shtrëngimi i rekordeve me dy çelësa;
- të kryejë lidhjen e tubit të kondesatës;
- të kryejë nastrimin e rregullt të linjave;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- të bëjë matjet, kontrollet, rregullimet e duhura dhe provën e funksionimit të lidhjes të linjave ftohëse të kondestatës;
- të zbatojë rregullat e kujdesit të veglave dhe pajisjeve të punës;
- të zbatojë standardet dhe kërkesat teknike gjatë realizimit të lidhjeve të linjave ftohëse të kondestatës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes mjedisit gjatë realizimit të lidhjeve të linjave ftohëse të kondestatës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

RM 6 Kursanti kryen operacionet përfundimtare të instalimit dhe kontrollon rrjedhjet.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse përpara fillimit të punës;
- të përgatitë vendin e punës për montimin e linjave instalimit dhe kontrollin e rrjedhjeve;
- të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe mjetet e punës për kontrollin të rrjedhjeve;
- të kryejë kontrollin e ndonjë rrjedhjeje në njësinë e brendshme apo në njësinë e jashtme;
- të kryejë nastrimin e pjesëve të zbuluara;
- të kryejë verifikimin e funksionimit të mirë të shkarkimit të kondesatës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes mjedisit gjatë realizimit të lidhjeve të linjave ftohëse të kondestatës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së montimit të kondicionerit një fazorë.
- Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e bizneseve dhe reparteve ku kryhen instalime dhe mirëmbajtje të kondicionerëve një fazorë:
